



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 22.10.2018, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Genc Sherifi, Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Sami Boroci, Eman Rahmani, Fadil Gashi dhe Egzon Azemi.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Ylli Rugova, drejtor i Drejtorisë së Kulturës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Agim Kuleta, kryesues**.

Njëzéri u miratua ky

**REND I DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për konsulta paraprake për Propozimrregulloren komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
3. Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2018 (TM 3);
4. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën e Prishtinës 2019-2021;
5. Projektstatuti i Qendrës Kulturore të Prishtinës;

6. Propozimvendimi për ndryshimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat e Herticëve";
7. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e KKSB-së;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Zeqir Haxhisë dhe Fatmir Fejzullahut;
9. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të objektit të ish-Konviktit të nxënësve të SHM "Gjin Gazulli" Universitet Amerikan në Kosovë (AUK);
10. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Meliha (Zeqir) Rrmokut;
11. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Nexhat (Shaban) Dumnicës dhe Liman (Beqir) Jasharit;
12. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Hazir (Jahir) Tahirit dhe Qamile (Hazir) Vrapcanit;
13. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Bedri (Smajl) Prishtinës dhe Durim (Bedri) Prishtinës;
14. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Remzi (Bajram) Aliut dhe Vehbi (Bajram) Aliut;
15. Propozimvendimi për këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Muhamed (Zeqir) Bajgorës dhe Nuhi (Ilaz) Bajgorës;
16. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Nezir (Zeqir) Xhemshitit;
17. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ujup (Mustafë) Salihut dhe Shefqet (Mustafë) Rexhepit;
18. Propozimvendimi për dhënen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Policinë e Kosovës;
19. Propozimvendimi për dhënen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Fondacionin për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfoten";
20. Propozimvendimi për dhënen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
21. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Ismajl Vrapcit dhe Ramadan Vrapcit;
22. Të ndryshme.

**Agim Kuleta**, kryesues, hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës, duke cekur se në bazë të Rregullores, Komiteti ka të bëjë me çështjet që kanë të bëjnë me politikat e Komunës dhe çështjet në aspektin financiar që kanë të bëjnë, por jo edhe çështjet që janë faktike sikurse këtu, që gjysmën e pikave i kemi këmbim i pronave. Në bazë të kompetencave që i parashëh Rregullorja, në nenin 5, janë shumë të qarta, çdo gjë që ka të bëjë me aspektin financiar dhe politika këtu, në bazë të asaj që e kemi, kompetenca me Rregullore, janë

deri në pikën e pestë, janë politika të Komunës, të tjerat janë këmbime të pronave. Ne mund të diskutojmë, por sipas Rregullores këto janë kompetenca tona dhe si praktikë me shkuar nëse kemi pika, të caktuar propozim konkret nëse është drejtori këtu. E thotë se po e pranon këtë propozim konkret dhe e futë në material përmblledhje, është në rregull, nëse jo, ne mund ta hedhim në votim, nëse i merr votat shumicë me shkuar si propozim i komisionit.

**Agim Gashi** shprehu mendimin se çdo punë që bëhet, janë politika të Komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa është cilësuar si obligativ, andaj është mirë çdo pikë me kaluar përmes tij, sepse është filtër numër një dhe e lehtëson punën e Kuvendit.

**Halim Halimi** tha se çdo çështje rreth pronës duhet të kalojë në Komitetin e Pronës, e në Komitetin për Politikë e Financa është obligim, sepse këmbimi i pronës lidhet me aspektet financiare. Po ashtu, tha se është praktikë e mirë me kaluar këto çështjet e pronës edhe nëpër Bord të drejtoreve dhe kur të shkojmë në Kuvend, me pasur më pak diskutime dhe menjëherë me qenë të njoftuar me çështjet. Unë mendoj se këmbimi i pronës është obligim me kaluar në KPF.

**Agim Kuleta, kryesues**, theksoi se ky ishte vetëm propozimi im, mirëpo në kuadër të kompetencave nuk i gjeta këto, por ne mund të diskutojmë, i diskutojmë nëse ju e shihni të rëndësishme me i diskutuar.

**Sami Boroci** propozoi që të gjitha pikat që kanë me kaluar në Kuvend, të trajtohen në KPF, që me dhënë sugjerime, propozime, që në vendime të ekzekutivit në rast të veçantë, mundet me qenë e rëndësishme, mirëpo nuk kishte me qenë ndonjë problem edhe nëse selektohen në bazë të kompetencave, se edhe Komiteti i ka disa kompetenca të kufizuara, sidomos te votimi.

**Genc Sherifi** u shpreh i pajtimit me parafolësin, që të gjitha pikat të trajtohen në KPF, se janë në interes të Komunës.

**Halim Halimi** shprehu pakënaqësi, duke thënë se është hera e fundit, kryesues, që kur ta marr fjalën ndërhyr dikush, jujeni përgjegjës, të ndalet, e kryej fjalën pastaj e merr fjalën e jo me ndërhyrë kështu.

**Vala Peshku** u pajtua me parafolësit lidhur me diskutimin e pikave të rendit të ditës, ndërsa kjo mënyra e komunikimit ka filluar me u bërë problem, sepse diskutimi sot po bëhet në mënyrë interaktive, nuk është me dëgjuar monologun, duke marrë shënim e pastaj duke bërë replikë. Duhet me qenë pak më ekspedativ, nuk duhet me konsideruar këtë si ndërhyje në diskutim ose kur dikush diçka thotë, por është diskutim. Vetë diskutimi e ka kuptimin e interakcionit në mes gjithë anëtarëve që jeni grup.

**Agim Gashi** tha se funksionimi i këtij organi të Kuvendit i nënshtrohet njëfarë kodi, rregulle, andaj respektoni kodin e mirësjelljes, nuk ka nevojë me pasur përplasje, qoftë edhe çka po ndodh këtu, se janë disa specifika njerëzore edhe të traditës dhe këto rregullohen me ligj, dhe jemi të detyruar me i respektuar, kur dikush kërkon mos me ndërhyrë, mos të ndërhyhet, kur debati zhvillohet në kuptimin e lirë, atëherë mund të ketë ndërhyrje, shprehje mendimesh etj.

**Egzon Azemi** kishte një kërkesë sa i përket kësaj çështje, mos respektimit të njëri-tjetrit, ku asnjë herë nuk kam pasur problem kur e kam marrë fjalën në seanca se mbropa a po komenton kush, provokon apo ndërhyr dikush, asnjëherë nuk jam ankuar, mirëpo në

seancën e fundit ka qenë kufiri i fundit, se kanë ndodhur edhe ofendime më të rënda familjare. Le të jetë seanca e fundit që kam toleruar ofendime me familje, kështu që tash e tutje përgjegjësia i ka mbetur secilit individualisht, se nuk mundem me duruar ofendime të tilla që kanë ndodhur, kështu që edhe juve si kryesues kom me ju lajmëruar në mënyrë të shkruar, se ajo që ka ndodhë shpresoj të jetë hera e fundit.

**Fadil Gashi**, lidhur me këmbimin e pronave, tha se nuk pajtohem dhe nuk duhet me diskutuar për këto pika.

**Osman Bllaca** propozoi që pika e dytë të plotësohet dhe të riformulohet kështu: “**Propozimvendimi për konsulta paraprake për Propozimrregulloren komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.**”

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Eman Rahmani** shprehu mendimin që procesmbajtësit me i dhënë rëndësi më shumë, se çka kamë folur unë nuk është këtu e shkruar, andaj të tregohet më i kujdeshëm.

**Agim Kuleta, kryesues**, tha se ky është ekstract, duhet të jetë në pika të shkurtra çka thuhet me dy-tri fjali, ky nuk është transkript, ku përfshihet gjithë diskutimi, është incizimi që përmban çdo fjali.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

#### Pika e dytë

**Propozimvendimi për konsulta paraprake për Propozimrregulloren komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.**

**Osman Bllaca** dha sqarime lidhur me këtë propozimrregullore, duke cekur se qëllimi i saj është krijimi i një mekanizmi koordinues për të drejtat e fëmijëve, dhe do të dalë në diskutim publik, pastaj prapë e sjellim në Kuvend për miratim.

**Halim Halimi** theksoi se Propozimrregullorja do të shkojë në konsulta publik, por le ta analizojë Zyra ligjore mos kishte qenë më mirë të mos quhet Projektrregulloren komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, por me u quajtur Projektrregulloren për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, se po dihet që është komunale.

**Sami Boroci** tha se kjo rregullore prapë ka me ardhur në Kuvend, mirëpo kisha kërkuar prej ekzekutivit me përfshirë sa më shumë akterë profesionistë të kësaj fushe.

**Vala Peshku** u shpreh e pajtimit me mendimin e z. Boroci, por nuk ishte në dijeni se a janë konsultuar edhe organizatat e ndryshme që e kanë synim mbrojtjen e të drejtave të fëmijë vendore dhe ndërkombëtare.

**Agim Gashi** theksoi se ky propozim ka një bazë ligjore funksionale. Në Projektrregulloren për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, te neni 10, "Promovimi i të drejtave të fëmijëve", te pika 2 thuhet: "Kuvendi i Komunës organizon të paktën një seancë vjetore, për t'i diskutuar çështjet e të drejtave të fëmijëve", por nuk e di në Planin e punës së Kuvendit a e keni paraparë këtë, nëse jo, atëherë duhet me qenë në harmoni me Planin e punës së Kuvendit.

**Eman Rahmani** propozoi që Projektrregullorja të diskutohet edhe në secilën shkollë me këshillat e shkollës. Do të ishte mirë, sepse aty përfshihen nxënësit, prindërit, arsimtarët dhe ishin marrë ide, andaj do të duhej të diskutohej në secilën shkollë të Prishtinës.

**Agim Kuleta, kryesues**, tha se kishte qenë mirë me iu bërë ftesë se ka shumë shkolla.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për konsulta paraprake për Propozimrregulloren komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### Pika e tretë

**Raporti finansiar buxhetor i Komunës se Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2018 (TM3).**

**Valbona Makolli** dha sqarime, duke thënë se të hyrat për tremujorin e këtij viti raportues, për periudhën korrik - gusht - shtator ka qenë 7,963,135,81 €, apo 26.93% e planifikimit buxhetor dhe të hyrave vetanake. Sa i përket shpenzimeve buxhetore, për këtë periudhë është 14,099,427.51 €. Sipas kategorive ekonomike, shpenzimet janë këto: paga dhe mëditje 72.43%, mallra dhe shërbime 58.84%, shpenzime komunale 69.76%, shpenzimet në subvencione dhe transfere 59.12% dhe shpenzime kapitale 35.45%.

Po ashtu, ceku se më 12 tetor e kanë marr një konfirmim nga Ministria e Financave, se është bërë alokimi i bartjes së mjeteve prej vitit 2017 në të gjitha kategoritë ekonomike, sipas kërkesës së Komunës, në buxhetin e vitit 2018.

Sipas Zyrës së avokaturës, në Komunën e Prishtinës kemi një rritje të detyrimeve kontingjente në vlerë prej 28,790,566.17€.

Në emër të këstít të autobusëve të Trafikut Urban, është paguar kësti në vlerë prej 344,584.53 €. **Agim Gashi** tha se në këtë tremujor janë dyfishuar, është përmirësuar performanca e ultë e TM 2, por kur të analizohet buxheti parashihen të dhënat e sakta. Në të përfshihet edhe bartja e buxhetit, sepse atëherë përqindjet, rezultatet dalin të vlerësuara sa më saktë, se këto nuk janë të sakta. Po ashtu, duhet me pasur kujdes të mos rriten detyrimet kontingjente. Nëse vazhdon kjo rritje, nuk përashtohet mundësia që një vit Komuna ka me mbetur pa buxhet.

**Eman Rahmani** u shpreh i pajtimit me z. Gashi për këto përqindje që i ceku. Pasi buxheti është bartur, ky raport është krejt manipulim, se s'ka të bëjë asgjë me këto statistika që janë raportuar, se më 29 shtator është dërguar bartja e buxhetit, është kryer bartja e buxhetit dhe është dashur me hyrë në këtë tremujor. Kishte me qenë mirë me përgatitur për mbledhje të Kuvendit, me i përfshi në statistika, me i përmirësuar në numra këto të dhëna.

Ai kërkoi që të sillet një dokument, i cili do të pasqyronte se për mjetet që janë marrë me përbartues, sa kanë paguar interes, sa është vlera reale e këtyre borxheve, sa kishte qenë nëse

do të ishte paguar në mënyrë të rregullte dhe sa është vlera që është kryer me përmbarues, se ky është një dëmtim i madhe i buxhetit të Komunës.

**Vala Peshku** u shpreh se ne e kemi raportin finansiar buxhetor për periudhën 1 korrik - 30 shtator, përderisa lejimi i bartjes së buxhetit është bërë tani, më 12 tetor, s'ka qysh me u paraqitur ajo.

Unë protestoj ashpër ndaj termeve të tilla, siç u përdoren më herët këtu, se këto raportet janë manipuluese, sepse nuk janë manipulime. Protestoj ashpër ndaj kësaj gjuhe.

**Valbona Makolli**, sa i përket bartjes së mjeteve, tha se kemi pasur telashe me Ministrinë e Financave, se ka qenë periudha kur ne e kemi bërë bartjen e ata janë marrë me buxhet, alokimin e buxhetit e kanë lënë anash, bartjen e mjeteve deri sa është bërë ajo vij e alokimit. Në raportin TM 4 do të janë të përfshira këto bartje.

Sa i përket fjalës manipuluese, Eman, mundesh me ardhur në zyrën time ose në Ministri dhe i konfirmojmë këto të dhëna. Gabimi është te ne, se bartja është bërë shumë vonë.

**Agim Gashi** propozoi që pasqyrimi i drejtë është kur në raport thuhet bartja e buxhetit është vonuar 9 muaj dhe për shkak të vonesave të arsyeshme nuk kemi pasur mundësi me i përfshirë në pasqyrë, se ky është dokument valid zyrtar që e rrumbullakon një periudhë qeverisëse disa mujore.

**Valbona Makolli** premtoi se për mbledhjen e Kuvendit do ta rregulloj këtë raport me plotësimë. Kryesuesi e hodhi në votim Raportin, me propozimet e Agim Gashit për sqarime.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti finansiar buxhetor i Komunës se Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2018 (TM 3), me sqarimet që i kërkoi Agim Gashi, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### Pika e katërt

**Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën e Prishtinës 2019-2021.**

Osman Bllaca dha sqarime lidhur me këtë propozimvendim.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën e Prishtinës 2019-2021, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### Pika e pestë

**Projektstatuti i Qendrës Kulturore të Prishtinës.**

**Agim Gashi** lidhur me projektstatutin, tha se te neni 11 "Përgjegjësitë e drejtor /it - eshës së përgjithshme", te pika 1.3 thuhet: "Me pëlqim paraprak të Këshillit drejtues, miraton programin vjetor drejtori, por duhet të jetë e kundërt, "Drejtori propozon dhe harton planin vjetor të punës, ndërsa e miraton këshilli drejtues.

**Vala Peshku** bëri vërejtje për mospjesëmarrjen e drejtorit i cili e ka paraqitur pikën, është dashur me qenë këtu me prezantuar.

**Fadil Gashi** tha se është obligim me qenë në takim drejtorët.

**Sami Boroci** tha se do të ishte mirë që, në emër të Komitetit, me bërë një kërkesë të shkruar, me iu drejtar drejtorëve, me përfshirë edhe Kryetarin, që në raste kur të kenë pika me qenë me raporte drejtorët.

**Halim Halimi** tha se te neni 8, pika 3, ku thuhet: "DK-ja mundë të delegojë kompetencat e menaxhimit të përkohshëm të QKP- së tek organizatat profesioniste të fushës." Unë mendoj se mundet me dhënë përkohësiht për me i menaxhuar. Fjala "menaxhim" për mua po heq dorë prej institucionit si komunale dhe po ja lë në menaxhim një institucioni profesionist.

**Yll Rugova** dha sqarime, duke cekur se modeli është sikurse te Muzeu, e kemi të njëjtin model, ne si institucion jemi menaxhues, por një pjesë të kompetencave ia japim institucionit profesionist, ky është modeli që po e ndjekim.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Projektstatuti i Qendrës Kulturore të Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për ndryshimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat e Herticëve".**

**Yll Rugova** u shpreh se prapë e kemi një gabim, që është te Shkolla e Herticëve.

**Halim Halimi** tha këtë term e kemi pasur edhe herën e kaluar në Komitetin e mëparshëm, janë marrë vërejtjet, por prapë ka ardhur në të njëjtën mënyrë.

**Yll Rugova** tha se unë i kam propozuar të jetë "Shkollat te Herticët", por ata nuk janë pajtuar, ata po dëshirojnë me qen "Shkollat e Herticëve".

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndryshimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat e Herticëve" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e KKSB-së.**

**Osman Bllaca** dha sqarime, duke cekur se bëhet ndryshim në vendimin për themelimin e KKSB- së.

Nga përfaqësuesi i Kishës Protestante Ungjillore, në vend të Imir Gashit caktohet Belkize Cakolli.

Nga përfaqësuesja e Këshillit të prindërve, në vend të z. Tringa Ferri - Arapi caktohet z. Besa Halil Krasniqi.

Nga përfaqësuesi i komunitetit goran, në vend të z. Erna Sholla - Bahtijari caktohet Sevdija Ramadani.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e KKSB-së dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## Pika e tetë

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Zeqir Haxhisë dhe Fatmir Fejzullahut.**

**Agim Gashi** tha se është një gabim teknik, këtu e kemi në rend dite Zeqir Haxhisë, ndërsa në material është Kadri Berishës.

**Fatos Dibra** tha se në titull është gabim, sepse nuk është bërë ndarja, se këtu janë dy vendime, është për Fatmir Zejnullahun dhe Zeqir Haxhinë.

**Agim Gashi** kërkoi që kjo të përmirësohet për mbledhje të Kuvend.

**Sami Boroci** kërkoi që pikat që vinë në Kuvend të janë më të qarta, të harmonizohen në mes të drejtorëve përkatës se janë pika të ndjeshme, se në seancën e fundit na kanë qitur drejtorët neve si Kuvend si asamblistët në lajthitje, sepse kjo pikë është kontestuese, kishte me qenë mirë me u harmonizuar prej Kadastrit, pronës se secili prej neve nuk dëshiron me pasur shkelje ligjore.

**Eman Rrahmani** tha se në seancën e fundit, që e përmendi parafolësi, besoj ka qenë e qartë dhe është shpjeguar shumë mirë se çka është ligjore dhe jo ligjore. Unë besoj shumë shpejt kemi me ngritur kallëzim penal kundër Dren Kukajt, sepse në seancën e kaluar kemi votuar diçka të jashtëligjshme. Po ashtu, tha mos pritni se do të ketë harmonizime, se drejtoresha Nora iu ka treguar cilat procedura duhet me u ndjekur për me u realizuar ai këmbim dhe çdo informatë që ju është kerkuar ju ka kthyer dhe i ka sugjeruar çka me bërë për t'u bërë në mënyrë të rregullt.

**Agim Gashi** theksoi se kur folëm për kompetencat lidhur me rendin e ditës, u tha se është mirë që çdo pikë me kaluar nëpër Këshill të drejtorëve. Po të ishin trajtuar në Këshillin e drejtorëve pikat e rendit të ditës, sidomos ajo e seancës së kaluar, problemet ishin zgjidh brenda Bordit, sidomos te prona është praktikë, se Bordi i drejtorëve duhet me i trajtuar mirë ato pika para se me kaluar në Komitet.

**Halim Halimi** u shpreh i pajtimin me parafolësin, i cili ceku se po të ishin shqyrtuar në Këshillin e drejtorëve nuk kish ardhur deri te përplasja, se këtu te këmbimi i pronave e kemi Komitetin e pronës, duhet shqyrtuar një herë në këtë komitet e pastaj me ardhur në KPF dhe Kuvend.

**Genc Sherifi** tha se kryesuesi i Komitetit të pronës është nga radhët e LDK – së, atëherë pse nuk e keni thirrur Komitetin e pronës me i shqyrtuar këto pikë? Para një javë na ka ardhur materiali i KPF-së dhe si KPF me iniciuar Komitetin e pronës me i shqyrtuar rastet.

**Halim Halimi** theksoi se drejtori duhet me i thirrur ata, me iniciuar me mbajtur takim, ne nuk jemi si parti me mbikëqyrë Komitetin e pronës.

**Fatos Dibra** dha sqarime lidhur me këtë pikë.

**Fadil Gashi** theksoi se vetëm kjo pikë e këmbimit ka arsyetim dhe ka kompensim në rregull, të tjerat vetëm i keni sjellë dhe votoni shablon.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi per këmbimin e pronës së paluajtshme te Komunës me pronën private në pronësi të Zeqir Haxhisë dhe Fatmir Fejzullahut dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## Pika e nëntë

**Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të objektit të ish-Konviktit të nxënësve të SHM "Gjin Gazulli" Universitetit Amerikan në Kosovë (AUK).**

**Fatos Dibra** dha sqarime, duke cekur se Universiteti Amerikan në Kosovë (AUK), ka bërë kërkesë për shtyrjen e afatit të shfrytëzimit të objektit të ish-Konviktit të nxënësve të SHM "Gjin Gazulli" në 99 vjet, ose së paku 50 vjet, kështu që ekzekutivi ka menduar me ia dhënë për 50 vjet, éshtë vetëm rritje e afatit kohor.

**Agim Kuleta, kryesues**, bëri të ditur se ia kanë dërguar një shkresë dhe kanë kërkuar takim. E kam lexuar shkresën, arsyetimi éshtë se ata për me fituar donacione, u duhet me pasur objektin në shfrytëzimin afatgjatë.

**Egzon Azemi** theksoi se në parim jemi me ia dhënë për 50 vjet, se në arsyetim shkruan se kërkesa éshtë me e zgjatë këtë afat për me marrë donacion për ta rinoimin e konviktit dhe një pjesë e kanë për me rinouar bibliotekën. Mirëpo kërkesë e jona ka me qenë që bibliotekën me pasur të drejt ta shfrytëzojnë edhe studentët e UP-së. Gjithashtu, duhet me kërkuar si Kuvend, me u rritur numri i bursave, edhe ashtu AUK në vit i ndan afér 200 bursa, mos me ua bërë obligative, por si kërkesë me tentua me rritur këtë numër.

**Vala Peshku** shprehu mospajtim për dhënien e objektit në shfrytëzim AUK-së për 50 vjet, sepse éshtë universitet privat.

**Egzon Azemi** dha sqarime, duke cekur se AUK nuk éshtë universitet privat, nuk kishte pronar, kishë bord dhe nuk éshtë fitimprurës. 90% të fondeve që i merr AUK i bën pagat e profesorëve dhe shpërndarjen e 200 bursave që i bën në vit.

**Sami Boroci** tha se kishte menduar që AUK éshtë universitet privat, fitimprurës. Edhe pse faktikisht e ka një bord, mendoj se kur kemi kërkuar kompensim prej BQK-së, edhe AUK éshtë dashur me dhënë një kompensim në këtë rast. Mendoj se nuk duhet bllokuar, dhe pajtohem me parafolësin se duhet me rritur numrin e bursave dhe të paktën me dhënë një kompensim.

**Agim Gashi** shprehu mendimin se dhënia për 50 vjet éshtë e drejtë, po i ikim 99 viteve, që nënkupton me ia falë. Dhënia për 50 vjet éshtë afatgjatë dhe nuk kanë me pasur asnje pengës në ikjen e donacionit dhe kanë me u ndarë të kënaqr.

**Vala Peshku** pyeti z. Azemi se a ka informata se ka me pasur investime në bibliotekë, se në arsyetim nuk éshtë.

**Egzon Azemi** tha se ata kanë bibliotekë dhe ne duhet me bërë kërkesë, që gjithë studentët e UP-së me pasur të drejtë me shfrytëzuar bibliotekën.

**Vala Peshku** tha unë se kisha bërë kërkesë, por obligative këtë për bibliotekë, nëse dëshirojnë me marrë për 50 vjet, po ashtu kisha kërkuar një takim për një marrëveshje të mirëkuptimit me AUK për bursa, për bibliotekë.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të objektit të ish-Konviktit të nxënësve të SHM "Gjin Gazulli" Universitet Amerikan në Kosovë(AUK) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### Pika e dhjetë

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Meliha (Zeqir) Rrmokut.**

**Fatos Dibra** dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke cekur se kemi të bëjmë me këmbimin e pronës private të Meliha (Zeqir) Rrmokut, me sipërfaqe 524 m<sup>2</sup>, me pronën e paluajtshme të Komunës, me të njëjtën sipërfaqe 524 m<sup>2</sup>, ku një pjesë e kësaj prone është paraparë për rrugë të planifikuar.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Meliha (Zeqir) Rrmokut, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### Pika njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Nexhat (Shaban) Dumnicës dhe Liman (Beqir) Jasharit.

Eman Rrahmani pyeti se si ka mundësi me na ardhur me vlera financiare vlerësimi i pronave, a ka mundësi me kërkuar paraprakisht se sa e ka vlerën ajo pronë.

**Fatos Dibra** dha sqarime, duke thënë se është kompetencë ekskluzive e Ministrisë së Financave për vlerësimin financier. Ligjërisht është i rregulluar këmbimi, nëse njëra del që e ka vlerë më të madhe, atëherë bëhet kompensimi. Ky proces vazhdon së pari për vlerësim të ligjshmërisë në MAPL, pastaj shkon në Ministri të Financave, Ministria e Financave del në terren, i bën matjet, i bën aktet e vlerësimit me vlerë monetare. Pas akteve të vlerësimit, Kryetari mund të nënshkruaj kontratën me palët që kanë hyrë në këmbim.

Eman Rrahmani pyeti se a ka mundësi pas vlerësimit me na e sjellë në Kuvend vlerësimin e atyre pronave.

**Fatos Dibra** tha se mundemi me bërë praktikë, se në momentin që i pranojmë matjet e vlerësimit, me iu dërguar në e-mail me shikuar se si ka qenë vlerësimi i atyre pronave.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Nexhat (Shaban) Dumnicës dhe Liman (Beqir) Jasharit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### Pika e dytëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Hazir (Jahir) Tahirit dhe Qamile (Hazir) Vrapcanit.

**Fatos Dibra** dha sqarime, duke thënë se këmbimi bëhet në lagjen "Matin 1", ku prona private që merret është e parapamë për rrugë publike, sipas Planit Matit 1 dhe Planit zhvillimor urban.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Hazir (Jahir) Tahirit dhe Qamile (Hazir) Vrapcanit, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### Pika e tretëdhjetë

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Bedri (Smajl) Prishtinës dhe Durim (Bedri) Prishtinës.**

**Fatos Dibra** tha se kjo është "Kodrina", është me pëllqim paraprak, se Urbanizmi kur ka shkuar për leje ndërtimore, iu ka dhënë pëllqim paraprak me shkuar në Drejtori të Pronës me kryer këmbimin. Sipas dokumenteve të paraqitura, prona e cila hynë në këmbim është pronë private, e cila është e paraparë për interes publik, gjegjësisht rrugë.

**Fadil Gashi** tha se këtë pikë duhet me lënë kurë të vjen Dren Kukaj dhe na jap sqarime të hollësishme lidhur me këtë pikë.

**Halim Halimi** kërkoi sqarim se a është në rregull juridikisht.

**Fatos Dibra** tha në aspektin ligjor është në rregull.

**Vala Peshku** tha se i kemi edhe shumë pika që janë këmbim, drejtorin e Pronës nuk e kemi prezent me na i sqaruar, andaj a ka mundësi këto pika me u futur si paketë që të shkojnë në Kuvend, se ne nuk mundemi me i hequr prej rendit të ditës e në Kuvend diskutohen një nga një. Unë nuk mundem me dhënë vlerësim se a duhet me i përkrahur apo jo këto pika, sepse nuk kemi informata të mjaftueshme.

**Fatos Dibra** tha në aspektin ligjor, ligji e lejon këmbimin e pronave komunale për interes publik, nëse përfshihet rrugë, ndërtim i një shkolle etj., ligji e lejon këtë çështje, e çështje e Kuvendit është a dëshiron me marrë vendim me këmbyer atë pronë me pronën tjetër.

**Fadil Gashi** tha se kjo pikë nuk mund të futet në paketë, e të tjera mundemi mi i shti në paketë. Po ashtu tha se a mundemi mos me përkrahur, por në Kuvend ta dërgojmë.

**Agim Gashi** shprehu mendimin se problemi është se nuk po kemi me kë me debatuar këtë çështje, nuk është personi kompetentë këtu.

**Eman Rahmani** tha se kjo pikë le të shkojë në Kuvend, por pa mbështetjen e KPF-së, e bëjmë kërkesën në Kuvend me shti dhe me e hequr krejt nga rendi i ditës.

**Vala Peshku** tha se në Kuvend le të shkojë, por Komiteti nuk ka informata të mjaftueshme për ta kuptuar këtë këmbim.

**Kryesuesi konstatoi se me 5 pika për dhe 2 pika kundër, u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Bedri (Smajl) Prishtinës dhe Durim (Bedri) Prishtinës, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Osman Bllaca** pyeti se a po i dërgojmë në paketë të gjitha pikat që janë për këmbim për Kuvend, mirëpo këtu i kemi edhe tri pika, që janë dhënie ne shfrytëzim: pikën 18, pikën 19 dhe pikën 20, që janë Propozimvendime për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

**Pika e katërmëbëdhjetë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Remzi (Bajram) Aliut dhe Vehbi (Bajram) Aliut.**

**Pika e pesëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Muhamed (Zeqir) Bajgorës dhe Nuhi (Ilaz) Bajgorës.**

**Pika e gjashtëmbëdhjetë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Nezir (Zeqir) Xhemshitit.

**Pika e shtatëmbëdhjetë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ujup (Mustafë) Salihut dhe Shefqet (Mustafë) Rexhepit.

**Pika e tetëmbëdhjetë**

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Policinë e Kosovës.

**Pika e nëntëmbëdhjetë**

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Fondacionin për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfoten".

**Pika e njëzetë**

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

**Pika e njëzetenjë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Ismajl Vrapcit dhe Ramadan Vrapcit.

Kryesuesi konstatoi se u miratuan në paketë pikat 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, dhe dërgohen në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Procesmbajtësja  
Shyhare Islami

Kryesuesi i Komunitatit  
Agim Kuleta

